




Letërlajm i FSHB

Numri 1 – Prill 2006



Fjala e Drejtorit të Bordit

Mërësevini në Letërlajmin e FSHB Numri 1! Ne do të publikojmë letërlajmin e FSHB-së dy herë në vit për të ju informuar për aktivitetet dhe planet e FSHB-së.

Ju po e lexoni këtë meqë jeni të interesuar për të ndihmuar Maqedoninë dhe në veçanti popullin shqiptar. Qëllimi i FSHB-së është mbështetja e arsimit sipëror të shqiptarëve të talentuar në Maqedoni dhe jasht saj. FSHB beson se duke investuar në shqiptarët e talentuar ju do të investoni në ardhmërinë e Maqedonisë dhe të Ballkanit.

Motoja e FSHB-së është 'Nga shqiptarët për shqiptarët.' Kanë kaluar aot kohë kur të huajt duhej të kujdesen për problemet tona. Duhet të ndërmarrim iniciativë për të ndihmuar vetëveten! Bashkangjitu edhe ju shqiptarëve të mirënjohur veçse të kyqur në FSHB – shkencëtarë, artistë, autorë, afaristë, ish ambasadorë, mjekë dhe pedagogë – për të ndërtuar ardhmërinë tonë. Asnjë lloj donacioni nuk mund të thuhet se është i vogël. A mund të ndani një Euro në muaj për të përkrahur një student universitar? Vizitoni veb faqen tonë që të kuptoni më shumë për mënyrën e dhënjes së donacionit. Ose ju mund të na shkruani në adresën tonë të FSHB, PO Box 758, 1000 Skopje, Macedonia.

FSHB angazhohet për ndershmëri dhe transparencë në tërë punën e saj. Ky letërnjoftim është vetëm se një shembull i gatishmërisë tonë të jemi të hapur me opinionin për të gjitha aktivitetet tona. Ne gjithashtu do të bëjmë publike raportin financiar vjetor. Për t'u regjistruar për marrjen e këtij raporti dërgoni një email në financialreport@fshb.org.

Viti 2005 ishte viti i parë aktiv i FSHB-së. Reagimi i opinionit ishte pozitiv por ende mjaft i matur. Kujdesi i dhënjes së besimit të plotë nga ana e opinionit është rezultat i përvojave të hidhura në Maqedoni me organizatat të cilat nuk përmbushnin premtimet paraprakisht të dhëna. FSHB vërtetoi se mban fjalën e dhënë. Unë jam krenar që jam pjesë e FSHB-së dhe do të punoj me shumë zell që jo vetëm të ndihmojmë studentët por edhe të bëhemi shembull i shkëlqyeshëm i ndershmërisë.

Të investojmë së bashku në ardhmërinë tonë,

Steve Lied
Kryesues i Bordit
FSHB



Prezentimet para studentëve

Në qershor të vitit 2005 FSHB vizitoi komplekset në Tetovë – Univerzitetin e Evropës Jug Lindore (UEJL) dhe Univerzitetin Shtetëror të Tetovës (USHT) për të takuar studentët dhe profesorët e tyre dhe për t'i njoftuar me qëllimet e FSHB-së. U theksua se FSHB do të përqëndrohet në akordimin e bursave për studentë që studiojnë në lëmi deficiitare. Poashtu u sfiduan studentët në aspektin e shqyrtimit të mundësive të tyre për të dhënë donacione.

Deklarata e Transparencës

Fondacioni Shqiptar i Bursave përkushtohet për sinqeritet, integritet dhe përgjegjësi.

Deklarata e Transparencës së FSHB thekson se donacionet pranohen vetëm përmes kanaleve legale të llogarisë rrjedhëse bankare të FSHB. Donacionet me para të gatshme në dorë janë të papranueshme. Fondet për bursa do të akordohen në të njëjtën mënyrë legale, përmes transfertës bankë-në-bankë. Raportet financiare vjetore të FSHB do të jenë në dispozicion për opinionin e gjërë. Fituesit e bursave poashtu do të shpallen publikisht në medime.

Takimi me anëtarin e Kuvendit të FSHB-së Ismail Kadare

FSHB është krenar që në rradhët e veta e ka Ismail Kadare në rolin e anëtarit të Kuvendit të Përgjithshëm. Me rastin e vizitës së Z-ri Kadare tll UEJL-it në Tetovë për pranimin e titullit Doktor Nderi të Univerzitetit, anëtarët e Bordit të FSHB-së Prof. Abdurauf Pruthi dhe Steve Lied u takuan me te me ç'rast diskutuan aktivitetet e FSHB-së.



Steve Lied, Ismail Kadare, Abdurauf Pruthi

Lexoni për aktivitete të tjera e FSHB

www.fshb-mk.org/page125.html

Që të mësoni më shumë lidhje me anëtarët e organeve udhëheqëse të FSHB vizitoni faqen

www.fshb-mk.org/page115.html

Donatorët dhe Sponsorizuesit

FSHB është mirënjohës ndaj të gjithëve që kontribuan përmes donacioneve dhe sponsorizimeve gjatë vitit 2005. Këta njerëz dhe ndërmarrje mundësuan që FSHB të akordon 30 bursa univerzitare për vitin akademik 2005-2006.

Donatorët

Renova Doo
Sa & Sa Kompani
American School Of Kosova
Western Union - Maqedoni
Dr. Zan Mitrev
Orteks
Turan Xhemaili
Nexhat Tahiri - Slupçan
Euro-Polog Doo
Steve & Karen Lied
Abdurauf Pruthi
Adnan Hoxha
Ordinanca 'Linkest' - Shkup
Bugarinovska Jovka ASNOM 2
HROM Promet Doo - Shkup
Viva Dent - Gostivar
Enis Bexheti - M.Reçica
Bedri Sinani
Agim Shuku
Antigona Travel Tours doo
ERA Medika - Kërçovë
Senat Ferati
Bekir Jonuzi - Slatinë
Sal-Kom 2 Import-Export
Kadri Muharemi - Tetovë
Ordinaca 'Dr. Pellumb Bitri' - Kumanova

Sponsorizuesit

Eurolinija
Radio VATI
Lajm
Koha Ditore
Fakti
TVM - shqip
TV Gurra - Kërçovë
TV Festa - Kumanovë
TV Koha - Tetovë
Smaragd Kompani
ProCredit Bank

Konkursi për bursa univerzitare 2005

Prej 1-17 shtator 2005 FSHB shpalli konkursin e parë për bursa univerzitare. Konkursi u shpall në media – gazetë dhe radio – si dhe në veb faqen e FSBH-së www.fshb.org. U planifikuan të akordohen tridhjetë bursa për lëmitë deficiitare të studimit të cekura në vijim:

- Shkenca natyrore 7 bursa
- Shkenca politeknike 6 bursa
- Mjekësi 6 bursa
- Shkenca ekonomike 4 bursa
- Artet 4 bursa
- Shkenca juridike 3 bursa

Nga 237 kandidatë që dorëzuan aplikacionet e tyre, 155 sosh i plotësuan kushtet minimale për konkurim. Këto kushte ishin:

- Aplikuesit duhet të kenë të regjistruar vitin e dytë ose më sipër në njërin nga institucionet universitare në Republikën e Maqedonisë ose jashtë saj si studentë të rregullt, (studentët e vitit të parë nuk kanë të drejtë të aplikojnë)
- Nota mesatare: për shkenca natyrore, shkenca politeknike dhe mjekësi mbi 7.5; për shkenca ekonomike, shkenca juridike dhe artet mbi 8.0
- Aplikuesit duhet të jenë shtetas të R. Maqedonisë

FSHB përdori një program kompjuterik gjatë vlerësimit të kandidatëve. Sipas sistemit në vijim u fitua një rezultat me poena për secilin kandidat::

Lëmitë deficiitare

emri	Vlera në poena
SHKENCAT NATYRORE	40
SHKENCAT EKONOMIKE	40
SHKENCAT POLITEKNIKE	40
MJEKËSI	40
SHKENCAT JURIDIKE	40
ARTET	40

Nota mesatare

Not.mesat.	vlera në poena
< 7.50	0
7.50 - 7.99	10
8.00 - 8.49	15
8.50 - 8.99	20
9.00 - 9.49	25
9.50+	30

Viti shkollor

Viti i studimeve	Vlera në poena
viti 1	0
viti 2	7
viti 3	8
viti 4	9
viti 5+	10

Te ardhurat mujore

Të ardhura	Vlera në poena
< 1001	20
1001 - 2500	15
2501 - 4000	10
4001 - 5500	5
5501+	0

Rezultati maksimal do të ishte 100 poena.

Komisioni për Përzgjedhje morri vendimet e veta në shumicën e rasteve në bazë të poenave të fituar. Në këtë mënyrë përzgjedhja është më objektive ku theksi është në suksesin e kandidatit.

Fituesit e Konkursit për Bursa Univerzitare për vitin 2005 janë:

<u>Bursistat</u>	<u>nga</u>	<u>universiteti</u>	<u>fakultet</u>	<u>drejtim</u>
Arita Sabriu	Tetovë	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Natyrore	Biokimi
Njomza Hasani	Gostivar	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Shkencat Natyrore	Biologji
Flamur Mehmeti	Kërçovë	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Natyrore	Fizike
Artan Abazi	Gostivar	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Natyrore	Informatike
Arjeta Ceka	Tetovë	Universiteti i Evropës Jug- Lindore - Tetovë	Shkencat Natyrore	Kompjuterike
Media Baftiari	Tetovë	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Shkencat Natyrore	Matematike
Mukadeze Dauti	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Natyrore	Matematike
Sabedin Emini	Kërçovë	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Politeknike	Arkitecture
Fati Iseni	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Politeknike	Elektroteknik
Fisnik Musai	Tetovë	Technische Universitat Wien ne Austri	Shkencat Politeknike	Elektroteknik
Artrim Qamili	Tetovë	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Politeknike	Elektroteknik
Seid Rexhepi	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Politeknike	Makineri
Flurim Hajruli	Gostivar	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Shkencat Politeknike	Ndertimtari
Amira Sela	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Mjekesi	Farmakologjia
Naser Abdi	Tetovë	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Mjekesi	Mjekesi e Pergjitheshme
Abdije Bilalli	Gostivar	Universiteti i Prishtinës - Kosova	Mjekesi	Mjekesi e Pergjitheshme
Valvita Reçi	Strugë	Universiteti i Prishtinës - Kosova	Mjekesi	Mjekesi e Pergjitheshme
Arbnora Kajolli	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Mjekesi	Stomatologji
Bunjamin Xhaferi	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Mjekesi	Stomatologji
Ilir Sopaj	Kumanovë	Universiteti I Prishtinës - Kosova	Artet	Arti Figurativ - pikturë
Fatos Lumani	Strugë	Universiteti I Tiranës - Shqipëria	Artet	Muzike
Mimoza Peza	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Artet	Muzike
Altin Ziba	Strugë	Universiteti I Tiranës - Shqipëria	Artet	Muzike
Gafur Sulejmani	Shkup	Universiteti i Evropës Jug- Lindore - Tetovë	Shkencat Ekonomike	Administratë biznesi
Albina Ziba	Strugë	Universiteti i Evropës Jug- Lindore - Tetovë	Shkencat Ekonomike	Administratë biznesi
Suzana Ahmedri	Shkup	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Shkencat Ekonomike	Financa
Evzal Bekteshi	Tetovë	Universiteti i Evropës Jug- Lindore - Tetovë	Shkencat Ekonomike	Financa
Evisa Kica	Strugë	Universiteti i Evropës Jug- Lindore - Tetovë	Shkencat Juridike	Administratë publike
Arbër Ademi	Kumanovë	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Shkencat Juridike	Drejtesi
Naim Kamishi	Shkup	Universiteti Shën Kiril dhe Metodi - Shkup	Shkencat Juridike	Shkencat Politike

Konkursi për bursa pasuniverzitare 2006

Në mars 2006 FSHB ka shpallur konkursin për bursa pasuniverzitare dhe studime specializimi. Konkursi zgjatit nga 25 mars deri me 21 prill 2006.

Do të jepen 4 bursa me lartësi prej 1,500 EURO. Bursat dedikohen për mbulim të pjesërishëm të shpenzimeve për studime pasuniversitare dhe specializime.

Kushtet e aplikimit janë tre:

- Kandidati të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i regjistruar në studime pasuniversitare ose specializim në vitin akademik 2005/06
- Të studion në një lëmi deficitare nga drejtimet:
 - Mjekësi
 - Shkenca natyrore
 - Art

Vizitoni veb faqen tonë www.fshb.org që të informoheni kur dhe si të aplikoni.

Cilët janë hapat e ardhshëm

Në vitin 2006 FSHB do të ofrojë mënyra më të përshtatshme për dhënje të donacioneve nga ana e personave fizik dhe ndërmarrjeve për të siguruar bursa studentore. Në plan kemi:

- Linjë telefonike celulare për donacione përmes MobiMak
- Ekspozim të broshurave dhe fletëpagesave në më shumë vende publike
- Evenimente kulturore
- Përfaqësues të fondacionit në qytetet tjera të Maqedonisë

Në vitin e parë u përqëndruam në mbledhjen e fondeve nga shqiptarët e Maqedonisë. Tani pas një viti punë, ne poashtu do të drejtojmë apelin tonë drejt diasporës shqiptare duke ju vërtetuar atyre se ne ishim në gjendje të ndihmojmë vetëveten me ato kushte që i kishim.

Në www.fshb.org ka informata për aktivitetet e FSHB.

25 mars - 21 prill 2006
Konkursi
Bursa pasuniveritare dhe specializime

Organet e FSHB

FSHB përbëhet prej tri organeve: Kuvendi i Përgjithshëm, Bordi Drejtues dhe Këshilli Mbikqyrës.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Përgjithshëm, të Këshillit Mbikqyrës dhe të Bordit Drejtues të FSHB punojnë vullnetarish, duke mos marrë as rrogë apo çfarëdo kompensimi tjetër për punën e tyre.

Kuvendi

Abdurauf Pruthi
Adelina Marku
Ali Aliu
Anton Sereçi
Bajrush Mjaku
Blerim Grubi
Don Lush Gjergji
Enver Maliqi
Ferid Murati
Ilirjan Rusi
Inva Mula
Ismail Kadare

Luan Starova
Muharrem Nexhipi
Naser Nagavci
Nebi Hoxha
Nigjare Nagavci
Ruzhdi Lata
Sedat Lumani
Shaban Prevalla
Shaziman Alili
Sihana Badivuku
Steve Lied

Këshilli drejtues

Steve Lied
Abdurauf Pruthi
Blerim Grubi
Naser Nagavci
Sedat Lumani
Nebi Hoxha
Nafi Saraçini

Këshilli mbikqyrës

Murtezan Ismaili
Ramiz Abdul
Gazmend Kadri

Si të jepni donacion

Donacioni juaj do të shfrytëzohet për të ndihmuar studentët e talentuar për të kryer studimet e tyre universitare dhe pasuniveritare. Donacionet pranohen me **TRANSFERTA BANKARE, ONLINE** ose me **ÇEK**. Vizitoni veb faqen tone www.fshb.org për detajat ose na dërgoni email tek adresa kontakt@fshb.org.

FONDACIONI SHQIPTAR I BURSAVE



Mbështetja e arsimit sipëror e shqiptarëve të talentuar në Maqedoni

Kutia Postare 758, 1000 Shkup, Maqedoni

kontakt@fshb.org

www.fshb.org